

	
ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësi: Unit:	20
Jednica: No. of pages:	- 19 -
Nr. Prot.: Prot. No.:	16/2023
Br. Prot.: Date:	26.12.2023
Br. stranica: Datum:	
Prishtinë	



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE

PËR

PROCEDURAT E PROKURIMIT NË OMK

Prishtinë, Dhjetor 2023

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS** në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1 të Ligjit nr. 04/L-150, për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22 paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenit 23 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, e miratuar në mbledhjen e datës 17 janar 2019, e plotësuar dhe e ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 26 dhjetor 2023, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr 11/2023 të Kuvendit të OMK-së, datë 26 dhjetor 2023)

### **Kapitulli I – Dispozitat e Përgjithshme**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave të prokurimit që kanë karakter publik mbi bazën e parimeve konkurruese, për qëllime të furnizimit, ofrimit të shërbimeve apo kryerjen e punëve të caktuara, sipas nevojave për veprimtarinë e ligjshme të Odës.

#### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet për nevojat e aktivitetit ekonomik që ka për qëllim krijimin e kushteve për veprimtarinë e Odës që nuk mund të sigurohet nga veprimtaria administrative, ndërkaq zhvillohet për nevojat e funksioneve të Odës.

#### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

1. Në kuptim të tekstit të kësaj rregulloreje, termet dhe akronimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- 1.1 **Oda** – nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;
- 1.2 **Prokurim** – nënkupton blerje, marrje me qira apo cilado mënyrë e kontraktimit të furnizimit me mallëra, shërbimeve apo kryerjen e punëve që porositën në emër të Odës;
- 1.3 **Kontratë** – nënkupton punën juridike të cilën e lidhë Oda në cilësi të Autoritetit Kontraktues dhe subjektin i cili ka fituar të drejtën për të bërë furnizimin, për të kryer shërbimin, për të kryer punë të caktuara apo për të dhënë në shfrytëzim sendin e caktuar për nevojat e shprehura të Odës;

- 1.4 **Kontratë për punë** – nënkupton kontratën që për lëndë të saj ka kryerjen e punëve që mund të jenë nga sfera e ndërtimitarisë, teknologjisë apo nga ndonjë fushë tjetër që shërben për një funksion ekonomik apo teknik;
  - 1.5 **Kontratë për furnizim** – nënkupton kontratën që për lëndë të saj ka blerjen, qiramarrjen, huazimin e produkteve, respektivisht sendeve që janë në qarkullim pasuror. Kjo kontratë mbulon po ashtu edhe furnizimet me sendet që janë në funksion të mirëmbajtjes dhe të instalimit;
  - 1.6 **Kontratë për Shërbime** – është kontratë e cila për lëndë të saj ka kryerjen e shërbimeve për nevojat për të cilat është shprehur interesimi nga Autoriteti Kontraktues;
  - 1.7 **Kontratë Kornizë** – është lloj i kontratës e cila lidhet për një periudhë të caktuar kohore dhe e cila mund të ketë për lëndë qoftë furnizimin, kryerjen e shërbimeve të porositura apo kryerjen e punëve të caktuara. Kjo kontratë lidhet për qëllime të ekzekutimit të saj sipas porosive periodike të kontraktuara;
  - 1.8 **Ofertues** – nënkupton personin fizik apo juridik i cili ofron kryerjen e furnizimeve, shërbimeve apo punëve;
  - 1.9 **Procedura e hapur** – nënkupton procedurën e prokurimit që ka karakter publik dhe në të cilën mund të ofertojë cilido subjekt i interesuar;
  - 1.10 **Procedurë e kufizuar** – nënkupton procedurën e prokurimit ku cilido ofertues mund të parashtrijë ofertën e tij, por në kualifikim thirren vetëm ofertat e përzgjedhura nga organi kompetent për vlerësim;
  - 1.11 **Procedura e negociuar** – nënkupton procedurën e prokurimit në të cilën oda si Autoritet Kontraktues përzgjedhë operatorin ekonomik sipas zgjedhjes së saj dhe negociacion kushtet e kontratës me një apo më shumë operatorë ekonomik;
  - 1.12 **Prokurim njëburimor** – është procedurë e prokurimit në të cilën Oda kërkon propozimin e operatorit të caktuar ekonomik pa i përfillur procedurat e përgjithshme të prokurimit, pa pasur qëllim
  - 1.13 **Tender ndërkombëtar** – nënkupton procedurë të lidhjes së kontratës me subjekte të huaja që ofrojnë shërbime, furnizime apo kryerje të veçanta të punëve;
  - 1.14 **Ditët** – nënkupton ditët kalendarike;
  - 1.15 **Autoriteti Kontraktues** – nënkupton Odën si subjekt i cili zhvillon procedurën e prokurimit dhe hyn në marrëdhënie kontraktuale me subjektin me të cilin ka lidhur kontratë; dhe
  - 1.16 **Operatori ekonomik** – nënkupton subjektin i cili ka lidhur kontratë me Odën sipas qëllimit të kontratës së lidhur.
  - 1.17 **Zyrtari i lartë administrativ** – nënkupton Kryetarin e Odës;
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

#### Neni 4

##### Klasifikimi i Konkursit të Projektimit sipas Vlerës

1. “Konkurs i projektimit me vlerë të madhe” konsiderohet me sa vijon:
  - 1.1. konkursi i projektimit që organizohet si pjesë e procedurës që shpie drejt ose që përfshinë shpalljen e kontratës fituese për shërbime, vlera e parashkuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se njëqind e njëzet e pesë mijë (125,000.00) Euro; ose
  - 1.2. konkursi i projektimit në të cilin shuma e përgjithshme e çmimeve të konkursit dhe e pagesave për pjesëmarrësit është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se njëqind mijë (100,000.00) Euro.

2. "Konkurs i projektimit me vlerë mesatare" konsiderohet me sa vijon:

2.1. konkursi i projektimit që organizohet si pjesë e procedurës që shpjen drejt ose përfshin dhënien e kontratës së shërbimeve vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë ose më e madhe se dhjetë mijë (10,000.00) Euro, por më e vogël se njëqind e njëzet e pesë mijë (125,000.00) Euro; ose

2.2. konkursi i projektimit në kuadër të së cilit shuma e përgjithshme e çmimeve dhe pagesave për pjesëmarrësit është e barabartë ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se dhjetë mijë (10,000.00) Euro por më pak se njëqind mijë (100,000.00) Euro.

3. Konkursi i projektimit që nuk përfshihet në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni konsiderohet "konkurs i projektimit me vlerë të vogël".

## **Kapitulli II – Inicimi i procedurave të prokurimit**

### **Neni 5**

#### **Iniciativa për fillimin e procedurës**

1. Zyrtari i lartë administrativ, në cilësi të funksionarit me kompetenca ligjore për tu përkujdesur për funksionimin e Odës, identifikon nevojën për iniciimin e procedurave të prokurimit.
2. Me rastin e identifikimit të nevojave, qofshin ato për furnizim, shërbime të caktuara apo kryerje të punëve, Zyrtari i lartë administrativ për vlerat që tejkalojnë shumën e përgjithshme prej 3,000.00 €, parashtron propozimin pranë Këshillit Drejtues të Odës për të aprovuar fillimin e procedurave të prokurimit.
3. Për nevojat e fillimit të procedurave të prokurimit për të cilat vlera e përgjithshme e kontratës nuk e tejkalon vlerën prej 3,000.00 €, Zyrtari i lartë administrativ autorizon ndërmarrjen e veprimeve për fillimin e procedurave të prokurimit.
4. Të gjitha Komisionet për zhvillimin e procedurave të prokurimit emërohen nga Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së me aprovim të Kryetarit të OMK-së, në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm, Kryetari i OMK-së është përgjegjës për emërimin e Komisioneve për zhvillimin e procedurave të prokurimit në Odë.
5. Për nevojat e përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit në OMK, do të themelohen Komisioni për përcaktimin e specifikacioneve të prokurimit, Komisioni për hapje të ofertave dhe Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertave.
6. Dispozitat e këtij neni zbatohen për të gjitha llojet e procedurave të prokurimit që janë paraparë me këtë rregullore.

### **Neni 6**

#### **Fillimi i procedurës së prokurimit**

1. Procedura e prokurimit, pas aprovimeve që kërkohen nga Neni 5 i kësaj rregulloreje, fillon me publikimin e Ftesës për ofertim për të vazhduar me publikimin e njoftimit për kontratë.

2. Publikimi i njoftimit për kontratë bëhet përmes publikimit në ueb faqen zyrtare të Odës dhe në të paktën një nga gazetat ditore që publikohen në nivel vendi.
3. Pas publikimit të njoftimit për kontratë, subjektet e interesuara mund t'i drejtohen Shërbimit Profesional, gjegjësisht zyrtarit të autorizuar për çështje financiare, për ta siguruar dosjen e tenderit. Subjektet e interesuara lidhur me detajet dhe sqarimet shtesë, mund të kërkojnë sqarime të tilla dhe se sqarimet e ofruara nga Autoriteti Kontraktues do t'i dërgohen të gjithë ofertuesve të tjerë.
4. Kërkesa për sigurim të dosjes së tenderit mund të bëhet vetëm nëse kërkesa e tillë është bërë para skadimit të afatit për paraqitje të ofertave nga ofertuesit. Shërbimi Profesional do të sigurojë në bazë të kërkesës së palëve të interesuara dosjen e tillë në afat prej 3 ditëve nga dita kur është paraqitur kërkesa e tillë.

### **Neni 7 Njoftimi për Kontratë**

1. Njoftimi për Kontratë do të përmbajë të paktën këto nga informacionet:
  - 1.1 Përshkrimin e përgjithshëm të qëllimit të Kontratës;
  - 1.2 Limiti kohor për parashtrimin e kërkesave për sigurim të dosjes së tenderit;
  - 1.3 Shumën e përgjithshme buxhetore e paraparë për vlerën e Kontratës;
  - 1.4 Lloji i Kontratës për të cilën është shpallur njoftimi;
  - 1.5 Kohëzgjatja e Kontratës apo afatet kohore për përfundim;
  - 1.6 Informacionet ekonomike, financiare dhe teknike;
  - 1.7 Kushtet për pjesëmarrje;
  - 1.8 Kushtet e veçanta të Kontratës;
  - 1.9 Lloji i procedurës së prokurimit;
  - 1.10 Kriteret e dhënies;
  - 1.11 Informacionet administrative; dhe
  - 1.12 Informacionet lidhur me të drejtën e ankimit dhe informacionet të tjera shtesë.
2. Varësisht nga nevojat dhe lloji i Kontratës që synohet të lidhet, përbërja e njoftimit për dhënie të kontratës mund të ndryshojë. Përpilimi i njoftimit për nevoja të veçanta bëhet në konsultim me Zyrtarin e lartë administrativ.

### **Neni 8 Përgatitja e dosjes së tenderit**

1. Pas autorizimit të nismës për hapjen e procedurës së prokurimit, Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së, në mungesë të tij Zyrtari i lartë administrativ i Odës, do të caktojë Komisionin për caktimin e specifikacioneve të tenderit.
2. Komisioni për specifikacione do të përbëhet nga tre anëtarë, të cilët do të përcaktohen varësisht nga nevoja konkrete me qëllim të lidhjes së kontratës, duke pasur parasysh përgatitjet dhe njohuritë e tyre lidhur me objektin e kontratës.

3. Komisioni për specifikacione do të përgatisë specifikacionet lidhur me nevojën e shprehur për lidhje të kontratës duke identifikuar standardet cilësore për zbatim sa më të suksesshëm.
4. Komisioni për specifikacione do të përcaktojë gjithashtu kushtet e veçanta të Kontratës, të cilat do t'i përgjigjen specifikacioneve të përcaktuara për lëndën e kontratës.

#### **Neni 9** **Afatet e tenderëve**

1. Tenderët, respektivisht ftesa e drejtuar për ofertim do të qëndroj e hapur sipas llojit të Kontratës dhe atë:
  - 1.1 Kontratat me vlerë të madhe (vlera e të cilave tejkalon 10,000.00 €) do të jetë e hapur në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit;
  - 1.2 Kontratat me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €) do të jetë e hapur në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit;
2. Në raste të jashtëzakonshme, afatet e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shkurtohen për shkak të rrethanave të veçanta që e bëjnë të nevojshëm shkurtimin e afateve të tilla.
3. Kur vlerësohet se është në interes të zhvillimit të suksesshëm të procedurës së prokurimit, afatet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zgjatën më së shumti për kohën e dyfishtë se sa është paraparë për llojin e Kontratës.

### **Kapitulli III – Zhvillimi i procedurës së prokurimit**

#### **Neni 10** **Hapja e ofertave**

1. Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni për hapjen e ofertave, i cili përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve të zgjedhur nga Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së. Në mungesë të tij nga Zyrtari i lartë administrativ i Odës. Anëtarët e Komisionit për hapjen e ofertave nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit për caktimin e specifikacioneve për procedurë të njëjtë të prokurimit.
2. Pas përmbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave nga ofertuesit, Komisioni do të konstatojë se a ekzistojnë kushtet për të zhvilluar procedurën e hapjes së ofertave. Kushti themelor për të zhvilluar procedurën e hapjes së ofertave është parashtrimi i 1 (një) oferte nga operatori ekonomik.
3. Në rast se nuk është përmbushur kushti për hapje të ofertave, siç është përkufizuar në paragrafin 2 të këtij neni, Komisioni do të konstatojë në procesverbalin e veçantë. Në këtë rast, Njoftimi për kontratë duhet të përsëritet duke u publikuar sipas mënyrës së paraparë në këtë rregullore.

#### **Neni 11** **Njoftimi për hapje të ofertave**

1. Komisioni për hapje të ofertave, pasi që ka konstatuar se ekzistojnë kushtet për të bërë hapjen publike të ofertave, do të bëjë hapjen e tyre në ditën e fundit të dorëzimit të ofertave.
2. Për kohën dhe vendin e hapjes së ofertave, të gjithë ofertuesit do të njoftohen përmes dosjes së tenderit.
3. Dispozitat e tilla do të aplikohen përshtatshëmrisht edhe me rastin e zhvillimit të prokurimit të kufizuar.

#### **Neni 12**

##### **Hapja publike e ofertave**

1. Komisioni për hapje të ofertave do të bëjë hapjen e ofertave në prani të përfaqësuesve të autorizuar të ofertuesve që kanë parashtruar ofertat e tyre sipas njoftimit për kontratë.
2. Komisioni me rastin e hapjes së ofertave do të bëjë leximin e ofertës në kuptim të çmimit dhe specifikacionit të objektit të ofertës, përfshirë të dhënat që kanë të bëjnë me kushtet të veçanta që janë të specifikuar në njoftimin për kontratë.
3. Me rastin e leximit të të dhënave nga paragrafi 2 i këtij neni, njëri nga anëtarët që është caktuar për lexim të ofertave, pas çdo segmenti të lexuar do të kërkojë konfirmimin e të pranishmëve se a kanë kuptuar të dhënën e lexuar dhe se a ka nevojë që e dhëna e tillë të përsëritet.
4. Komisioni me rastin e hapjes së ofertave do të mbajë evidencë në procesverbalin e veçantë në të cilin do të shënohet rrjedha e hapjes së ofertave, vërejtjet e mundshme të pjesëmarrësve, të pranishmit në hapjen e ofertave, ofertat që janë hapur dhe çështjet të tjera që konsiderohen si të rëndësishme për evidencë.

#### **Neni 13**

##### **Vlerësimi i ofertave**

1. Vlerësimin e ofertave e bën Komisioni për vlerësim, i cili ka 3 (tre) anëtarë dhe zgjedhet nga Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së, në mungesë të tij nga Zyrtari i lartë administrativ i Odës.
2. Komisioni për vlerësim dhe përzgjedhje do të bëjë vlerësimin e ofertave në mbledhje të mbyllur pa praninë e përfaqësuesve të ofertuesve. Para fillimit të procedurës së vlerësimit, të gjithë anëtarët e Komisionit do të nënshkruajnë deklaratën e tyre nën betim.
3. Komisioni për vlerësim do të bëjë vlerësimin e ofertave jo më larg se 7 (shtatë) ditë nga dita kur është bërë hapja e ofertave nga Komisioni i hapjes së ofertave.

#### **Neni 14**

##### **Mënyra e vlerësimit**

1. Komisioni për vlerësim dhe përzgjedhje do të bëjë vlerësimin e ofertave duke u mbështetur në kriteret e mëposhtme:

- 1.1 Oferta më e favorshme ekonomikisht;
  - 1.2 Çmimi më i ulët i ofruar; dhe
  - 1.3 Konformiteti cilësor i ofertës.
2. Komisioni për vlerësim do t'i jep përparësi ofertës e cila përmban konformitetin cilësor të objektit të ofertës, duke u bazuar në arsyeshmërinë e çmimit të ofruar.
  3. Komisioni po ashtu gjatë vlerësimit do të vlerësojë përmbushjen e kushteve të veçanta që janë përcaktuar për ofertuesit që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.
  4. Gjatë vlerësimit të ofertave, Komisioni ka të drejtë që të kërkojë sqarime shtesë nga ofertuesi lidhur me paqartësitë teknike.
  5. Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material, apo në cilindo aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet. Autoriteti Kontraktues do të caktojë afat kohor të arsyeshëm për Operatorin Ekonomik për sqarim të tenderit të tyre. Nëse Operatori Ekonomik dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga Autoriteti Kontraktues tenderi përkatës do të refuzohet.

#### **Neni 15** **Eliminimi i ofertave**

1. Komisioni për vlerësim do të diskualifikojë ofertuesit të cilët nuk kanë arritë të parashtrajnë ofertat e tyre konform kushteve që janë përcaktuar me Nenin 12 të kësaj rregulloreje.
2. Krahas mospërmbushjes së kushteve sipas paragrafit 1 të këtij neni, ofertuesit do të diskualifikohen edhe në rast të parregullsive në dosjen e bashkëngjitur me ofertën, që ndërlidhet me dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të kontratës, si dhe tenderi jo normalisht i ulët.
3. Komisioni për vlerësim, për secilin ofertues do t'i shënojë arsyet e refuzimit në procesverbalin e vlerësimit.
4. Autoriteti Kontraktues në secilën fazë tenderuese eliminon një kandidat ose tenderues nga aktiviteti i prokurimit. Autoriteti Kontraktues njofton kandidatin ose tenderuesin me shkrim. Njoftimi përmban informatat të cilat ofrojnë arsyeshmërinë e eliminimit nga aktivitetet.

#### **Neni 16** **Njoftimi për dhënie të kontratës**

1. Njoftimi për dhënie të kontratës do të bëhet në të njëjtën mënyrë sikurse njoftimi për kontratë, siç është përkufizuar me Nenin 7 të kësaj rregulloreje.
2. Nga dita kur është publikuar njoftimi për kontratë, ofertuesit që kanë marr pjesë në procedurën e tillë të prokurimit, kanë të drejtë që të parashtrajnë ankesat e tyre.



3. Kontrata me ofertuesin më të suksesshëm nuk do të lidhet deri në kalimin e afatit për ankesë, respektivisht deri në vendosjen mbi ankesat eventuale të ofertuesve të tjerë.

#### **Neni 17**

##### **Anulimi i procedurës së prokurimit**

1. Autoriteti Kontraktues, nga njoftimi për kontratë, hapjes së ofertave, vlerësimit të tyre, njoftimit për dhënie të kontratës e deri në procedurat e ankimimit mund të anulojë procedurën e prokurimit.
2. Anulimi i procedurës së prokurimit mund të bëhet për shkak të mospërbushjes së kushteve dhe kriterëve që kërkohen sipas kësaj rregulloreje, apo kur në bazë të ankesës së ofertuesve që marrin pjesë në procedurën e prokurimit, evidentohet parregullsia e cila vë në dyshim objektivitetin e procedurës së zhvilluar të prokurimit.
3. Vendimi për anulim të procedurës së prokurimit bëhet varësisht nga faza në të cilën anulohet, respektivisht nga komisioni i cili vlerëson mospërbushjen e kushteve për vazhdim të procedurave të prokurimit.
4. Njoftimi për anulim të procedurës së prokurimit do të bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse është përcaktuar me Nenin 6 të kësaj rregulloreje.
5. Procedura e anuluar e prokurimit do të përsëritet jo më larg se 30 (tridhjetë) ditë nga dita kur vendimi me të cilin është anuluar procedura e prokurimit, është bërë i formës së prerë.
6. Ofertuesit që kanë marrë pjesë në procedurën e anuluar të prokurimit, kanë të drejtë që të parashtrojnë ankesën e tyre në afat prej 5 ditëve nga dita kur është bërë njoftimi për anulim të procedurës së prokurimit.

#### **Neni 18**

##### **Lidhja e Kontratës**

1. Me përfundimin e afatit për ankesë, pasi që të ketë kaluar afati i ankimimit apo është vendosur për ankesat eventuale nga ana e organit kompetent, Autoriteti Kontraktues do të lidh Kontratën me Operatorin ekonomik i cili është përzgjedhur në bazë të procedurës së prokurimit.
2. Lidhja e Kontratës sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet jo më larg se 5 ditë nga dita kur lidhja e kontratës është bërë e plotëfuqishme.
3. Kontrata lidhet me nënshkrimin e saj nga Zyrtari i lartë administrativ i Odës dhe përfaqësuesit të autorizuar të Operatorit ekonomik.

#### **Neni 19**

##### **Masa siguruese dhe tërheqja nga procedura e prokurimit**

1. Ofertuesit të cilët marrin pjesë në procedurën e prokurimit të kontratës me vlerë të madhe apo të mesme, obligohen që masën e sigurisë ta dorëzojnë në ditën e dorëzimit të dosjes së tenderit dhe dokumenteve përcjellëse të ofertës, ku masa e sigurisë duhet të bëhet përmes Kompanive të Sigurimit të licencuara të cilat operojnë në Republikën e Kosovës.
2. Masa siguroese do të deponohet në xhirollogarinë e Odës, në shumë prej së paku 10% të vlerës tenderit, por jo më shumë se 5,000.00 €.
3. Masa siguroese do tu kthehet të gjithë ofertuesve të cilët diskualifikohen për shkak të eliminimit në procedurën e vlerësimit të ofertave. Po ashtu, masa siguroese do tu kthehet ofertuesve të cilët kanë tërhequr ofertën e tyre para hapjes së ofertave.
4. Masa siguroese nuk do tu kthehet operatorëve të cilët e tërheqin ofertën e tyre pas hapjes së ofertave, si dhe ofertuesit i cili dështon që të nënshkruaj kontratën sipas afatit të paraparë për lidhje të Kontratës, në Nenin 18 të kësaj rregulloreje.
5. Ofertuesi mund të tërhiqet nga procedura e prokurimit deri para vlerësimit të ofertave nga Komisioni për vlerësim. Efekti i tërheqjes konsiston në pasojat e theksuara në këtë dispozitë.
6. Në rast se tërheqja është bërë para hapjes së ofertave, dhe me këtë është cënuar procedura e prokurimit, e njëjta nuk do të anulohet, por ofertuesi i tërhequr do të konsiderohet si i papërgjegjshëm.
7. Nëse autoriteti kontraktues vendos (zbulon) se ka ndodhur një ngjarje që kërkon konfiskimin e sigurisë së tenderit sipas paragrafit 1 të këtij neni autoriteti i tillë kontraktues do të (i) njoftojë tenderuesin përkatës me shkrim mbi vendimin e tillë. Sidoqoftë, nëse siguria e tenderit në fjalë është deponuar në formë të kredisë ose sigurisë bankare, autoriteti kontraktues duhet që së pari të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i marrë fondet përkatëse nga lëshuesi i tyre para se t'i dërgojë tenderuesit njoftimin e kërkuar nga fjalia e mësipërme. Autoriteti kontraktues do t'i lërë fondet e tilla të deponuara në xhirollogarinë bankare përderisa tenderuesi përkatës të ketë shpenzuar pa sukses të gjitha të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të autoritetit kontraktues. Pasi që tenderuesi t'i ketë shpenzuar pa sukses të drejtat e tij për të apeluar kundër vendimit të tillë, dhe nuk është pranuar asnjë urdhër nga një gjykatë kompetente që kërkon nga autoriteti kontraktues që të mos bëjë asnjë sistemim tjetër të fondeve në fjalë, autoriteti kontraktues do të:
  - 7.1. transferojë fondet e tilla të konfiskuara në xhirollogarinë e tij të përgjithshme rrjedhëse dhe për qëllime të kontabilitetit dhe tatimore, do t'i trajtojë fondet e tilla të konfiskuara të tenderit, si të ardhura të zakonshme.
8. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrajnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:
  - 8.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;
  - 8.2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;

8.3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose

8.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim.

9. Autoriteti kontraktues do të specifikojë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje, se cilat nga referencat e sipërpërmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dhe/ose referencat e tjera kërkohen prej tij.
10. Nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatori ekonomik i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm.
11. Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta. Ai duhet në këtë rast të dëshmojë për autoritetin kontraktues që ajo do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke prodhuar një ndërmarrje nga ato entitete për këtë qëllim. Në kushte të njëjta, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështeten në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera.
12. Dispozitat e këtij neni lidhur me masën e sigurisë nuk do të jenë të aplikueshme për kontratat me vlerë të vogël.

## **Neni 20**

### **Ankesat në procedurë të prokurimit**

1. Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, ofertuesit kanë të drejtën në ankesë, dhe atë për:
  - 1.1 të drejtën në ankesë që ka të bëjë me ofrimin e dosjes së tenderit në procedurë të njoftimit të kontratës;
  - 1.2 të drejtën në ankesë me rastin e vlerësimit të ofertave, respektivisht njoftimit për dhënie të kontratës; dhe
  - 1.3 të drejtën në ankesë për anulim të procedurës së prokurimit.
2. Ankesat nga paragrafi 1 duhet të parashtrihen në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita kur palët janë njoftuar, respektivisht kur është bërë njoftimi zyrtar lidhur me ndonjërin nga rrethanat e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni.
3. Ankesat e ofertuesve parashtrihen pranë Këshillit Drejtues të Odës, i cili do të vendos për ankesat eventuale, jo më larg se 30 ditë nga dita kur është dorëzuar ankesa. Përgjashtimisht nga rastet të tjera, vetëm ankesa ndaj njoftimit për dhënie të kontratës e pezullon procedurën e prokurimit.

## **Neni 21**

### **Qasja në dosjet e ofertuesve**

1. Dokumentacionet e dorëzuara nga ofertuesit, konsiderohen si dokumentacion që përmbanë sekret afarist, përjashtimisht të dhënave që kanë karakter publik.
2. Në rastet kur ofertuesit kërkojnë qasje ekskluzive lidhur me dosjet e ofertuesve të tjerë, kërkesat e tilla do të refuzohen nga Autoriteti Kontraktues duke konsideruar si cënim të sekretit afarist.

## **Kapitulli IV – Procedurat e veçanta të prokurimit**

### **Neni 22**

#### **Procedura e prokurimit për vlera të vogla**

1. Procedura e prokurimit për vlera të vogla zhvillohet për vlerat e përgjithshme të prokurimit deri në vlerë deri në 3,000.00 (tre mijë) € (euro).
2. Në rastet të tilla vendoset mbi bazën e të paktën 1 (një) oferte që ftohen drejtpërdrejt operatorët që u drejtohet ftesa për ofertë në mënyrë të drejtpërdrejtë.
3. Kriteret për përzgjedhjen e ofertës siç është përkufizuar me Nenin 12 të kësaj rregulloreje do të jenë të zbatueshme edhe për këtë lloj të procedurës së prokurimit.
4. Furnizimet, blerjet apo kryerja e punëve për nevojat dhe veprimarinë e Odës, që nuk tejkalojnë vlerën e përgjithshme prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) € (euro), do të porositën në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm me sigurimin e 1 (një) oferte të operatorit ekonomik të përgjegjshëm. Duke përfshirë edhe aktivitetin nga ky paragraf, për porosinë e bërë nevojitet aprovimi paraprak i Zyrtarit të lartë administrativ.
5. Të gjitha Komisionet për zhvillimin e procedurave të prokurimit emërohen nga Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së me aprovim të Kryetarit të OMK-së, në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm, Kryetari i OMK-së është përgjegjës për emërimin e Komisioneve për zhvillimin e procedurave të prokurimit në Odë.
6. Komisionet për furnizime dhe shërbime janë në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve. Komisioni ka kryesuesin, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të komisionit.

### **Neni 23**

#### **Procedura e prokurimit të kufizuar**

1. Procedura e prokurimit të kufizuar zhvillohet sipas përkufizimit që i është bërë kësaj procedure sipas Nenit 3, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.10.

2. Përzgjedhjen e së paku 1 (një) ofertuesi në mesin e ofertuesve të tjerë, e bënë Zyrtari i Lartë Administrativ i OMK-së, pas raportimit të Shërbimit Profesional për ofertat e pranuar.
3. Pas përzgjedhjes së 1 (një) ofertuesi në parakualifikim, pjesa tjetër e procedurës do të zhvillohet përshtatshëm sikurse procedura e hapur e prokurimit.
4. Vlera e kontratave të cilat lidhen përmes këtij lloji të procedurës së prokurimit, nuk e tejkalon vlerën e përgjithshme të kontratës më shumë se 3,000.00 (tre mijë) € (euro).

#### **Neni 24**

##### **Procedura e prokurimit të negociuar**

1. Procedura e prokurimit të negociuar do të bëhet në këto raste:
  - 1.1 Natyra e punëve, furnizimit apo shërbimit nuk lejojnë caktimin paraprak të çmimeve të përgjithshme;
  - 1.2 Specifikimet nuk mund të përkufizohen në detaje të mjaftueshme për të lejuar përzgjedhjen e ofertuesit më të suksesshëm siç mund të realizohet në procedurën e hapur apo të kufizuar;
  - 1.3 Ekziston rreziku që për shkak të natyrës së veçantë të lëndës së kontratës mund të paraqitet rreziku objektiv për shkaktimin e dëmit material; apo
  - 1.4 Kur për ekzekutimin e lëndës së kontratës kërkohen afinitete të veçanta për të cilat konsiderohet se kërkesat që rrjedhin nga kushtet e kontratës nuk mund të përmbushen rëndom nga operatorët ekonomik në treg.
2. Me rastin e inicimit të procedurës së negociuar të prokurimit, do të zbatohen përshtatshëm dispozitat e Nenit 4 të kësaj rregulloreje.
3. Negociimi me operatorët ekonomik do të bëhet nga një komision ad hoc, i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i OMK-së, në mungesë të tij Komisionin e emëron Kryetari i OMK-së. Me rastin e negociimit do të merren për bazë kriteret e përcaktuara me këtë nen.
4. Zyrtari i lartë administrativ do të nënshkruaj kontratën në bazë të rekomandimit të Komisionit ad hoc nga paragrafi 3 i këtij neni, pasi që kanë përfunduar negociatat me 1 (një) apo më shumë operatorë ekonomik, për të cilët është konsideruar se mund të ofertojnë sipas kushteve specifike që kërkohen për procedurën e negociuar të prokurimit.

#### **Neni 25**

##### **Procedurat për kuotimin e çmimeve**

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve, furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël nëse:

1.1. në rast të kontratave për punë përfshinë vetëm riparime apo mirëmbajtje, ose

1.2. në rast të mallrave ose shërbimeve (i) mallrat ose shërbimet përkatëse aktualisht janë në dispozicion nga operatorët ekonomik, (ii) mallrat ose shërbimet përkatëse nuk ka nevojë që të prodhohen ose përpunohen posaçërisht, në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues, dhe (iii) vetëm ekziston një treg për mallrat ose shërbimet e tilla.

2. Autoriteti kontraktues do t'u dërgojë njëkohësisht, së paku tre (3) operatorëve ekonomik një kërkesë më shkrim për kuotimin e çmimeve dhe, aq sa është e mundshme, sa më shumë operatorëve ekonomik sa është e nevojshme për të siguruar se konkurrenca efektive për kontratën përkatëse nuk dëmtohet.

3. Autoriteti kontraktues do t'i zgjedhë operatorët e tillë ekonomik dhe përndryshe të kryejë aktivitetin e prokurimit në një mënyrë që nuk ka për qëllim që të diskriminojë kundër një apo më shumë operatorëve ekonomik.

4. Operatori ekonomik që nuk e ka marrë kërkesën për kuotimin e çmimeve që u është dërguar operatorëve të tjerë ekonomik, ka të drejtë që, menjëherë pasi që ta kërkojë, të marrë kërkesën e tillë për kuotimin e çmimeve nga autoriteti përkatës kontraktues. Operatori ekonomik që nuk e ka marrë kërkesën për kuotimin e çmimeve, kërkesë kjo që u është dërguar operatorëve të tjerë ekonomik, gjithashtu ka të drejtë që të dorëzojë një kuotim të çmimeve si përgjigje ndaj kërkesës së tillë, edhe nëse operatori ekonomik e ka marrë kopjen e kërkesës ose informacion mbi kërkesën për kuotimin e çmimeve nga dikush tjetër dhe jo nga autoriteti kontraktues.

5. Kërkesa me shkrim për kuotimin e çmimeve do të: (i) përshkruajë, në përputhshmëri me nenin 28, punët, mallrat ose shërbimet, (ii) informojë të gjithë operatorët ekonomik se kuotimet e tyre duhet të përmbajnë një shumë të përgjithshme të çmimit të saktë që autoriteti kontraktues duhet ta paguajë në mënyrë që të marrë mallrat ose shërbimet përkatëse dhe se shumta e tillë e çmimit të saktë duhet të përfshijë çfarëdo dhe të gjitha tatimet dhe doganat e aplikueshme si dhe të gjitha tarifat e tjera të transportimit, sigurimit, instalimit ose tarifat, ngarkesat ose shpenzimet e tjera të çfarëdo lloji; dhe (iii) specifikojë datën deri në të cilën duhet të dorëzohen kuotimet e çmimeve.

6. Për një aktivitet të prokurimit që ushtrohet sipas paragrafit 1 të këtij neni, data deri në të cilën duhet të pranohet të gjitha kuotimet e çmimeve duhet që të mos jetë më pak se pesë (5) ditë nga data e dërgimit të kërkesës për kuotimin e çmimeve.

7. Nëse, në një aktivitet të prokurimit që ushtrohet sipas paragrafit 1 të këtij neni më pak se tre (3) operatorë ekonomik që rregullisht i ofrojnë punët, mallrat ose shërbimet përkatëse në treg dorëzojnë kuotime të përgjegjshme të çmimeve më shkrim në apo para afatit të fundit kohor të specifikuar në kërkesën për dorëzimin e kuotimeve të çmimit, autoriteti kontraktues do të anulojë aktivitetin e prokurimit. Në raste të tilla, nëse autoriteti kontraktues ende dëshiron që të prokurojë mallrat ose shërbimet përkatëse, atëherë ai do të fillojë një aktivitet të ri të prokurimit për mallrat ose shërbimet e tilla.

8. Operatori ekonomik mund të dorëzojë vetëm një kuotim të çmimeve gjatë aktivitetit përkatës të prokurimit. Operatori ekonomik nuk mund të ndryshojë kuotimin e tij të çmimeve pasi që kuotimi i tillë të jetë dorëzuar.

9. Për qëllime të aplikueshmërisë së dispozitave të tjera të këtij ligji, kërkesa për kuotim të çmimeve do të formohet në “ftesën për tenderim”.

## Neni 26

### Kontratat Publike Kornizë

1. Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, të kufizuar apo të negociuar për të dhënë një kontratë publike kornizë. Kontrata publike kornizë nuk do të mund të jepet duke përdorur çfarëdo procedure tjetër.

2. Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen.

3. Autoriteti kontraktues mund të shpërblejë një kontratë publike kornizë kur ka në plan të shpërblejë disa kontrata identike gjatë periudhës që do të përfshihet nga kontrata publike kornizë, dhe konkluzioni i një kontrate publike kornizë që mbulon kontrata të tilla do të reduktohet shpenzimet e prokurimit dhe administrimit të autoriteteve kontraktuese përkatëse.

4. Pas dhënies së kontratës në bazë të paragrafit 1. të këtij neni kontrata publike kornizë lejon autoritetin kontraktues që gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj të bëjë porosi ose të lidh nën-kontrata në bazë të mini-tenderëve.

5. Kontratat publike kornizë mund të shpërblehen:

5.1. një operatori ekonomik dhe në këtë rast duhet të përfshihen të gjitha kushtet e nevojshme për të lejuar që porositë të bëhen vetëm në bazë të kontratës, ose

5.2. më shumë se një operatori ekonomik, por të paktën tre, dhe në këtë rast duhet të përfshijnë kriteret e dhënies që do të përdoren për mini-tenderë. Kontratat e tilla kornizë mund të lënë në mënyrë të qartë disa kushte të veçanta të cilat do të përcaktohen në kontratat ndihmese.

6. Vetëm operatorët ekonomik që janë palë të kontratës publike kornizë mund të marrin pjesë në mini-tenderë, sipas nën-paragrafit 5.2 paragrafi 5 të këtij neni. Në rast të përdorimit të mini tenderëve autoriteti kontraktues i fton të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë palë të kontratës publike kornizë që të paraqesin ofertat e tyre me shkrim. Afati për dorëzimin e ofertave duhet të jetë së paku 5 ditë. Autoritetet kontraktuese duhet të shpërblejnë kontratën tek operatori ekonomik që ka dorëzuar ofertën më të mirë në bazë të kriterëve të dhënies të përcaktuara në ftesën për ofertim.

## Neni 27

### Procedura e prokurimit njëburimor dhe ndërkombëtar

1. Në të gjitha rastet kur konsiderohet se kryerja e një pune, furnizimi i caktuar apo kryerja e shërbimeve të veçanta, kërkohen nga një operator i cili posedon kapacitete të veçanta, qoftë në kuptim të burimeve njerëzore, dijës, posedimit të mjeteve të veçanta apo elementeve të tjera që e bëjnë jokonkurses me operatorë të tjerë, Autoriteti Kontraktues do të zhvillojë procedurë të veçantë të prokurimit, pa i përfilluar procedurat standarde të parapara me këtë rregullore.
2. Procedura e prokurimit njëburimor dhe atij ndërkombëtar mund të zhvillohen vetëm në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues.
3. Standardet e përgjithshme të negociimit të përfshira në këtë rregullore dhe Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, do të jetë i zbatueshëm gjatë zhvillimit të procedurave të tilla të prokurimit.

#### **Neni 28**

##### **Dispozita e përgjithshme për procedurat e veçanta të prokurimit**

1. Për të gjitha procedurat e veçanta të prokurimit, lidhja e kontratës do të bëhet nga Zyrtari i lartë administrativ.
2. E drejta e ankesës, përjashtimit prokurimit njëburimor dhe atij ndërkombëtar, do të zbatohen përshtatshëmrisht procedurat e ankimit, siç janë paraparë në dispozitat e kësaj rregulloreje.

#### **Neni 29**

##### **Nënkontraktimi**

1. Nënkontraktimi nga ana e Operatorit Ekonomik me rastin e ekzekutimit të kontratës së lidhur me Autoritetin Kontraktues është e lejuar vetëm me njoftimin paraprak të cilin e bën Operatori Ekonomik tek Autoriteti Kontraktues.
2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet bërë me shkrim dhe t'i drejtohet Zyrtarit të lartë Administrativ, i cili varësisht nga lënda e kontratës së prokurimit do ta miratojë apo do ta refuzojë nënkontraktimin e kërkuar nga Operatori Ekonomik.

### **Kapitulli V- Rregullat për Konkursin e Projektimit**

#### **Neni 30**

##### **Dispozitat e Përgjithshme**

1. Rregullat për organizimin dhe udhëheqjen e një konkursi për projektim duhet të jenë në përputhshmëri me dispozitat e përcaktuara në këtë kapitull dhe ato do t'u komunikohen të gjithë personave dhe ndërmarrjeve që i përgjigjen njoftimit për konkursin e projektimit.
2. Konkursi i projektimit do të ushtrohet në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtat afate kohore siç ushtrohen aktivitetet e prokurimit për kontratat me vlerë të madhe që zbatojnë procedurat e hapura ose të kufizuara.



3. Nëse, pa kurrfarë qëllimi që të diskriminojë në favor ose kundër një personi ose ndërmarrje, autoriteti kontraktues vendos se: (i) konkursi i nevojshëm i projektimit mund të sigurohet, furnizohet ose ekzekutohet nga personi ose ndërmarrja me kualifikimet adekuate profesionale ose teknike dhe (ii) autoriteti i tillë kontraktues do të pranojë vetëm konkurset e dorëzuara nga personat ose ndërmarrjet që i posedojnë kualifikimet e caktuara minimale, autoriteti kontraktues do t'i vendosë kushtet për kualifikimet e tilla në mënyrë të qartë, objektive dhe jo-diskriminuese dhe do t'i publikojë të gjitha kërkesat e tilla në njoftimin për konkursin e projektimit.

### **Neni 31 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij kapitulli vlejnë për të gjitha konkurset e projektimit.

### **Neni 32 Njoftimi mbi Konkursin e Projektimit**

Kur autoriteti kontraktues planifikon të mbajë një konkurs për projektim, i njëjti do të përgatisë njoftimin mbi konkursin e projektimit në gjuhët zyrtare.

### **Neni 33 Formulari dhe Përmbajtja e Njoftimeve për Konkursin e Projektimit**

Të gjitha njoftimet lidhur me konkursin e projektimit do të përpilohen dhe publikohen në pajtim me formularin e aplikueshëm standard.

### **Neni 34 Publikimi i Njoftimeve për Konkursin e Projektimit**

1. Rregullat që drejtojnë publikimin e një njoftimi për konkursin e projektimit janë të njëjta me rregullat e parashtruara për publikimin e njoftimeve të kontratës për kontratat që e kanë vlerën e njëjtë me konkursin përkatës të projektimit.
2. Rregullat që drejtojnë dërgimin dhe publikimin e një njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit janë të njëjta me rregullat që drejtojnë dërgimin dhe publikimin e njoftimit për dhënien e kontratës, për kontratat që e kanë vlerën e njëjtë me konkursin përkatës të projektimit.
3. Përveç për njoftimet mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i janë dërguar një pjesëmarrësi nga autoriteti kontraktues, asnjë njoftim dhe asnjë informacion në një njoftim, nuk mund të bëhen publike ose të zbulohen para një personi ose ndërmarrjeje, para publikimit të tij në përputhshmëri me këtë nen.

### **Neni 35 Njoftimi mbi Rezultatet e Konkursit të Projektimit**

Autoriteti kontraktues që ka mbajtur konkursin e projektimit, duhet që brenda dy (2) ditëve të punës pas përfundimit së konkursit të përgatisë një njoftim lidhur me rezultatet e konkursit të projektimit në gjuhët zyrtare.

## **Neni 36**

### **Mjetet e komunikimit**

1. I tërë komunikimi dhe këmbimi i informacioneve i përmendur në dispozitat e këtij kapitulli mund të kryhet përmes letrës, faksit ose mjeteve elektronike, varësisht sipas zgjidhjes së autoritetit kontraktues.
2. Komunikimi dhe këmbimi i informacioneve të përfshira në kuadër të këtij kapitulli do të bëhet në mënyrën me të cilën sigurohet mbrojtja e tërësisë dhe sekretit të të gjitha informacioneve të dorëzuara nga pjesëmarrësit, dhe mundësinë që autoriteti kontraktues të mund të studiojë përmbajtjen e të gjitha planeve ose projekteve pas skadimit të afateve të caktuara për pranimin e tyre.
3. Autoriteti kontraktues do të sigurojë që njoftimi për konkursin e projektimit dhe rregullat e specifikuar në paragrafin 1. të nenit 27 të cekin se, nëse planet ose projektet paraqiten përmes mjeteve elektronike, dërguesi është i detyruar që t'i paraqes autoritetit kontraktues originalin fizik - ose, kur është e përshtatshme kopje të të gjitha dokumenteve, certifikatave, dëshmimeve dhe deklaratave që kërkohen nga autoriteti kontraktues jo më vonë se në afatin e caktuar për pranimin e planeve ose projekteve.

## **Neni 37**

### **Përbërja dhe Vendimet e Komisionit**

1. Komisioni duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Komisionit duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.
2. Komisioni do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.
3. Kriteret për shpërbllim të cilat përdoren për konkurs projektimi janë obliguese vetëm me kriteret matëse dhe peshat të paraqiten në aspekte monetare kurdo që është e mundur dhe nuk kufizohen me kriteret e përmendura në paragrafin 1. të nenit 7, pasi që edhe kriteret që ndërlidhen me vlera artistike mund të merren parasysh. Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen.
4. Asnjë person jashtë Komisionit nuk mund të ndikojë ose të tentojë të ndikojë në vendimet e Komisionit ose në opinionin e cilitdo nga anëtarët e Komisionit.
5. Personave që nuk janë anëtarë të Komisionit do t'u zbulohet vetëm vendimi i Komisionit. Diskutimet dhe opinionet e anëtarëve të Komisionit do të mbahen si sekret nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Asnjëri nga anëtarët e Komisionit nuk do të zbulojë përmbajtjen e diskutimeve të tyre para një personi tjetër që nuk është anëtar i Komisionit, përveç kur kërkohet nga një urdhër me shkrim nga një gjykatë kompetente.

## **Kapitulli VI – Dispozitat përfundimtare**

**Neni 38**  
**Zbatueshmëria**

1. Për të gjitha çështjet që nuk janë paraparë me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe legjislacioni dhe praktika e prokurimit publik në Republikën e Kosovës.
2. Format me të cilat zbatohen procedurat e prokurimit, propozohen nga Zyrtari i lartë administrativ dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i Odës.

**Neni 39**

**Hyrja në fuqi**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen të gjitha vendimet e Kuvendit të OMK-së që janë në kundërshtim me dispozitat e saja.
2. Ndyshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njejtës procedurë së miratimit.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së.

**Prishtinë, 26 dhjetor 2023**

Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdiu, mr.sct.

